



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: Histori e Kulturës shqiptare bashkëkohore

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Fatmira Rama
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

Përshkrimi:

Përshkrimi: Është disiplinë, që synon të njohë studentët me njohuri të kulturës qytetare shqiptare përgjatë shek. XX dhe fillimit të shek.XXI, që nga Shpallja e Pavarësisë së vendit (28 nëntor 1912). Kjo në disa rrafshje të zhvillimit të kulturës qytetare dhe përgjatë disa etapave themelore historike: në fushën e zhvillimeve urbanistike e arkitekturore në qytete, atë arsimore, të publicistikës dhe letërsisë, të arteve figurative, muzikore, teatrore, të kinematografisë etj. Kjo disiplinë synon të evidentojë arritjet dhe veçoritë përkatëse, figurat e shquara në këto fusha, elementët ndërlidhës me vende të tjera ballkanike, europiane e më tej.

Temat e leksioneve:

Leks. 1. Veprimtaria arsimore e qeverisë së përkohshme të Ismail Qemalit, 1912-1913. Arsimi gjatë Luftës së Parë Botërore në zonën e pushtimit austro-hungarez, italian dhe atë francez. Politikat arsimore të shtetit shqiptar në vitet 1920-1924 për një shkollë me karakter unik dhe laik. Kongreset arsimore të viteve 1920-1922, 1924.

Leks. 2. Shtirirja dhe konsolidimi i arsimit shqiptar në vitet e Republikës Shqiptare dhe të Monarkisë Shqiptare. Zgjerimi i arsimit fillor dhe atij të mesëm në vitet 1924-1939. Hartimi i legjislacionit dhe reforma arsimore e Mirash Ivanajt, 1933.

Leks. 3. Tipare dhe veçori të publicistikës shqiptare në vitet 1912-1939. Zgjerimi i vazhdueshëm i saj dhe kontributi në ndërtimin e shtetit shqiptar dhe emancipimin e shoqërisë.

Leks. 4. Rrymat ideologjike në Shqipëri në vitet 20-30 të shek. XX.

Leks. 5. Figura të shquara të publicistëve shqiptarë.

Leks. 6. Artet figurative dhe muzika qytetare. Shoqëritë kulturore në vend dhe disa protagonistë të njohur të viteve 20-30-të të shek.XX si Kristo Kono, Marie Kraja, Tefta Tashko Koço etj.

Leks. 7. Lëvizja amatore teatrore, në vitet 1920-1939.

Leks. 8. Botimet dhe shkenca në Shqipëri në vitet 20-30 të shek. XX.

Leks. 9. Kinemaja në Shqipëri dhe xhirimet e huaja në gjysmën e parë të shekullit XX.

Leks. 10. Veçori të lëvizjes kulturore dhe arsimore gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Leks. 11. Arsimi në Shqipëri në vitet 1945-1967. Reforma e viteve 1946 dhe e viteve 1968-1970. Veçori të arsimit shqiptar në vitet 1970-1990.

Leks. 12. Letërsia shqiptare e realizmit socialist pas Luftës së Dytë Botërore: arritjet, censura dhe ndikimi i politikës në zhvillimin e saj. Ismail Kadare një zë i shquar i letërsisë shqiptare të kësaj periudhe (1945-1990)

Leks. 13. Artet figurative, zhvillimet muzikore, teatrore, dhe të kinematografisë në Shqipëri: 1945-1990. Krijimi i institucioneve profesionale në Shqipëri: Teatri Popullor, Ansambli i Ushtrisë, Teatri i Operas dhe Baletit dhe Festalet e Këngës në Radio-Televizion. Ndikimi i politikës dhe lufta partiake dhe shtetërore ndaj influencave perëndimore.

Leks. 14. Veçori të urbanistikës të qyteteve shqiptare në vitet në vitet 1945-1990 dhe ndikimi i arkitekturës sovjetike.

Leks. 15. Letërsia dhe artet në vitet e tranzicionit demokratik. Larmia publicistike dhe media vizive në Shqipëri në vitet 1990-2000. Veçoritë e zhvillimit arsimor dhe lidhjet me botën perëndimore.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve

- Angazhimi në seminare:

10% e notës

- Testi I: në javën e 6-të

10% e notës

- Testi II: në javën e 10-të

10% e notës

- Detyra e kursitose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):

20% e notës

- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim

50% e notës

- Gjithsej:

100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. H. Boriçi, *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare*, Lezhë: Gjergj Fishta, 1998

2. *Histori e artit shqiptar*, vëll. II, Tiranë: Instituti i Artit dhe Arteve, 2002

3. H. Koliqi, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*. (Prishtinë: Libri Shkollor, 2002).

4. *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 3 (Tiranë: Toena, 2007); *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 4. (Tiranë: Toena, 2009).

Literatura plotësuese:

1. Elsie, Robert. *Historia e letërsisë shqipe*. (Tiranë-Pejë: Dukagjini, 1997).

2. Hoxha, Abaz. *Arti i shtatë në Shqipëri*. (Tiranë: Albinform, 1994).

3. Vrioni, Qerim. *150 vjet fotografi shqiptare*. (Sarandë: Milosao, 2009).

4. Hamiti, Sabri. *Letërsia moderne shqiptare*, Gjysma e parë e shek. XX. (Tiranë: Albas, 2000).

5. Jup Kastrati, Faik Konica – New York: Gjon Lekaj, PUBL, 1995.

6. Fatmira Rama, *Dukuri arsimor gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Argeta LMG, Tiranë, 2005

7. Iljaz Gogaj – Mirash Ivanaj: Tiranë: Erik, 2004

8. Spiro Kalemi, Marie Kraja – Paluca, Tiranë: Omsca 1, 2001.

9. Eriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri 1945-1960*, Tiranë, Akademia e Shkencave, 2005

10. Nasho Jorgaqi, Fan Noli, Vëll. I, II, Tiranë, 2002.